



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK / DMP
Nr. Prot. 03-3423/12
Data 26.09.2012
Prut No.
Datum
Date
PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DEÇAN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
DEČANIMA/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN DEÇAN

Regj.Nr. 2430 / 12

Gjykata Komunale per Kundërvajtje në Deçan, me gjyqtarin Nexhat Musaj dhe sekretarin juridike Hasime Qorraj duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj te pandehurit Jashar Salih Dobraj nga fshati Carrabreg KK-Deçan, për shkak te shkeljes se dispozites se nenit 17 paragrafi 1,1 te Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë te Zyrtareve te Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te gjithë Personat Zyrtarë , e në veshtrim me dispozitat e nenit 30.123,195 dhe nenit 198 pika 10 te Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt.20.09.2012 bie kete:

AKTE VENDIM

PEZULLOHET , procedura kundërvajtëse ndaj te pandehurit Jashar Salih Dobraj nga fshati Carrabreg KK-Deçan, për shkak te shkeljes se dispozites se nenit 17 paragrafi 1,1 te Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë te Zyrtareve te Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te gjithë Personat Zyrtarë, konform nenit 198 pika 10 te Ligjit mbi Kundërvajtjet për shkaqe te argumentuara në arsyetim te ketij aktevendimi.

ARSYETIM

REPUBLIKA E KOSOVES –AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT –PRISHTINË me kerkesen nr. 01-2169-12 te dates.04.06.2012 ,ju ka drejtuar kesaj gjykate qe ndaj te pandehurit te zhvillohet procedura kundërvajtëse dhe pas sigurimit te provave te duhura te shpallet fajtor dhe te denohet në bazë te Ligjit.

Me zhvillimin e procedures kundërvajtëse i pandehuri Jashar Dobraj , ne mbrojtjen e vet ka deklaruar : Lidhur me kundervajtjen per te cilen me ngarkon Agjesia Kunder Kurrupcionit ne Prishtinë : kam per te deklaruar se per vitin 2011 unë e kam deklaruar pasurinë ne Agjensionin Kosovar kunder kurrupcionit per vitin 2011 me daten .14.03.2012 .Si provë deshmie gjykates i prezenton vertetimin e fleteparanimit te dukumentacionit perkates per deklarimin e prejardhjes dhe gjendjes se pasurisë me nr.03-207/2012 te dates. 14.3.2012.

Agjencia Kundër Korrupcion me shkresen nr. 01-2849/12 te dates 10.08.12 ju ka drejtuar kesaj gjykate qe ndaj te pandehurit , te pezullohet procedura kundërvajtëse sepse bëhet terheqja e kerkeses se bërë me daten 15.06.12 nr. 01-2169/12 për mos deklarimin e pasurisë ndaj zyrtarit te lartë ,sepse është bërë një leshim teknik dhe nuk është shlyer nga lista e zyrtareve te lartë publik qe kanë deklaruar pasurinë ,andaj kerkojmë pezullimin e procedures për zyrtarin e lartë publik.

Andaj Gjykata duke u bazuar në deklaratën e të pandehurit, proven e prezentuar nga i pandehuri dhe shkresën zyrtare nga Agjensioni Kundër Korrupsion, ka ardhur në përfundim që të pezullohet procedura kundërvajtëse sepse i pandehuri e ka prezentuar vertetimin që e ka deklaruar pasurinë si dhe faktin se organi kompetent ka hequr dorë nga Kërkesa për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse, andaj në bazë të rrethanave që u cekën më lartë është pezulluar procedura kundërvajtëse konformë nenit 198 pika 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij akteve vendimi.

Me nga një kopje të këtij akteve vendimi njoftohen ushtruesi i kërkesës dhe i pandehuri

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DEÇAN Regj.nr
2430 /12 dt 20.09.2012

UDHZIM JURIDIK :



Kundër këtij akteve vendimi pala e pa knaqur ka të drejtë të ankesojë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij akteve vendimi. Ankesa ushtrohet pa takim për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë.